



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr.2004/36

PER KONKURRENCËN

Kuvendi i Kosovës,

Duke marrë parasysh Rregulloren e Misionit të Përkohshëm Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë Nr. 1999/1 të 25 Korrikut 1999, mbi “Autoritetin e Administratës së Përkohëshme në Kosovë,” të ndryshuar; Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/24 të 12 Dhjetorit 1999 “Mbi ligjin në fuqi në Kosovë” të ndryshuar ; dhe Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/9 të 15 Majit 2001, mbi “Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë”, veçanërisht Kreu 5.1 (a) dhe (ç), 5.7, 9.1.1, 9.1.26 (a), 9.3.3 dhe 11.2 e tutje; dhe

Duke njohur nevojën për harmonizimin e rregullimit të praktikave konkurruese në Kosovë përgjithësisht, me kërkesat e Unionit Evropian si dhe standardet e praktikave më të mira ndërkombëtare;

Miraton:

LIGJIN PER KONKURRENCËN

PJESA I
ÇËSHTJET E PËRGJITHSHME

Qëllimi dhe fushëveprimi
Neni 1

1.1. Qëllimi i këtij ligji është që të siguroj zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme të tregut në Kosovë duke ndaluar veprimet që e kufizojnë, shtypin ose çrregullojnë konkurrencën.

1.2. Ky ligj do të vlen për të gjitha ndërmarrjet e angazhuara në aktivitete ekonomike brenda, ose që kanë ndikim ekonomik brenda, territorit të Kosovës.

1.3. Ky ligj nuk do të zbatohet për marrëdhëniet punëdhënës-punëmarrës..

Përkufizimet Neni 2

2.1. Kurdo që përdoren në këtë ligj, secili nga termet dhe shprehjet vijuese, ka kuptimin e cekur më poshtë përveç, nëse konteksti në të cilin këto terme shfaqen, qartësisht ka kuptim tjetër:

“**Marrëveshje**” do të thotë çdo kontratë, marrëveshje, mirëkuptim ose aranzhim, qoftë ajo me shkrim apo jo.

“**Praktika e bashkërenduar**” do të thotë një aktivitet që ka të bëjë me bashkëpunimin joformal ndërmjet ndërmarrjeve dhe që nuk bazohet në një vendim ose marrëveshje formale.

“**KKK**” do të thotë Komisioni Kosovar i Konkurrencës që themelohet sipas Pjesës V të këtij ligji.

“**Person**” do të thotë person fizik.

“**Ky ligj**” do të thotë këtë ligj dhe aktet dhe instrumentet plotësuese normative të nxjerrura në mbështetje të - ose sipas autorizimit të këtij ligji, duke përfshirë edhe rregullat e zbatimit të nxjerrura në përputhje me ose sipas autorizimit të këtij ligji.

“**Autoritet publik**” do të thotë çdo autoritet ekzekutiv qeveritar, organ publik, ministri, departament, agjensi, ose autoritete të tjera të ngjajshme që ushtrojnë kompetenca ekzekutive, ligjdhënëse, rregullative, administrative ose gjyqësore në territorin e Kosovës. Termi “autoritet publik” përfshin përndryshe secilën organizatë apo mekanizëm privat deri në atë shkallë sa ato ushtrojnë ndonjerën prej pushteteve të sipërcekura në pajtim me autorizimin e dhënë sipas aktit nën normativ apo normativ ose në pajtim me delegimin e autorizimit nga ndonjë autoritet tjetër.

“**Ndërmarrje publike**” do të thotë një autoritet publik ose ndërmarrje në pronësi, të kontrolluar ose të administruar nga një autoritet publik, pjesërisht ose plotësisht, nëse ndërmarrja ose autoriteti i tillë publik është e angazhuar në ushtrimin e aktiviteteve ekonomike.

“**Tregu Përkatës**” do të thotë fahu i tregtisë për të cilin është kufizuar konkurrenca në një zonë të caktuar gjeografike, duke përfshirë të gjitha produktet dhe shërbimet e zëvendësueshme dhe të gjithë konkurrentët tek të cilët konsumatorët mund të drejtohen në afat të shkurtë, në rastë se kufizimi apo abuzimi rezulton në ngritje materiale të çmimit.

“**Ndërmarrje**” do të thotë (i) çdo ndërmarrje (duke përfshirë edhe ndërmarrjet private të biznesit), ndërmarrjen publike, ortakërinë, ndërmarrjen e përbashkët, person juridik, shoqatë, projekt, degë, zyrë, ose ndonjë organizatë apo mekanizëm tjetër (pavarësisht nga pronësia, vendqëndrimi apo vendi i afarizmit ose veprimtarisë) të angazhuar në aktivitete ekonomike, edhe/ose (ii) çdo person që vepron në emër të cilësdo nga të mëparshmit.

2.2. Përkufizimet më të hollësishme të termeve të përdorura në këtë ligj, si dhe përkufizimet e termeve të tjera, mund të përcaktohen apo të paraqitën në aktet nën-normative për zbatimin e këtij ligji; me kusht që, sidoqoftë, përkufizimet e tilla më të hollësishme të termave tjerë, të mos e cenojnë zbatimin e cilësdo nga dispozitat e këtij ligji.

PJESA II KONKURRENCA

KREU 1 NDALIMET KRYESORE

Ndalimet kryesore te marrëveshjeve, vendimeve të shoqatave të ndërmarrjeve dhe praktikave të bashkërenduara që kufizojnë konkurrencën

Neni 3

3.1. Marrëveshja ndërmjet ndërmarrjeve, vendimi i një shoqate të ndërmarrjeve ose një praktikë e bashkërenduar e ndërmarrjeve është e ndaluar nëse (i) mund të ndikon në tregëtinë brenda Kosovës, (ii) ka për qëllim të saj ose mund të ndikojnë në mënyrë të dukshme në parandalimin, kufizimin ose çrregullim e konkurrencës në Kosovë, dhe (iii) zbatohet ose ka për qëllim të zbatohet në Kosovë. Ndalimi nga neni 3.1 vlen njëloj për të gjitha marrëveshjet, vendimet dhe praktikave, qoftë ato të shkruara apo jo.

3.2. Pa paragjykuar fushëveprimimin e përgjithshëm të nenit 3.1, ndalesat e vendosura nga ai nen në mënyrë specifike zbatohen për një marrëveshje, vendim ose praktikë që:

- a. në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë përcakton çmimin shitës ose blerës ose çfarëdo afati apo kushti tjetër në tregëti ose biznes;
- b. kufizon ose kontrollon prodhimin, tregun, zhvillimin teknologjik ose investimet;
- c. kufizon, ndan ose merr pjesë në tregun ose në një apo më shumë burime të furnizimit;
- d. zbaton kushte të ndryshme për transaksione të ngjashme me ndërmarrje të tjera, duke i vendosuar ato në një pozitë të papëlqyeshme konkurruese;
- e. kushtëzon që lidhja e kontratës të varet nga palët tjera kontraktuese, përmes kushteve të tjera plotësuese që për nga natyra e tij/saj e që sipas natyrës dhe praktikës së zakonshme tregëtare, nuk kanë lidhshmëri me objektin e kontratës së tillë.

3.3. Marrëveshja ose vendim që është i ndaluar me nenin 3.1 është i pavlefshëm dhe i pazbatueshëm.

3.4. Personi, ndërmarrja ose shoqata e ndërmarrjeve që tenton të ekzekutojë, detyrojë, zbatojë dhe/ose ushtrojë marrëveshjen, vendimin ose praktikën në fjalë, është lëndë e gjobave administrative dhe penale që vendosen nga Pjesa VI e këtij ligji.

3.5. Përveç nëse konteksti qartë kërkon një interpretim të ndryshëm, secila dispozitë e Pjesës I të këtij ligji që parashihet të zbatohet për, ose në lidhje me, një marrëveshje ndërmjet ndërmarrjeve, duhet të interpretohet në atë mënyrë që të siguroj se dispozita e tillë zbatohet në mënyrë të barabartë për, ose në lidhje me, vendimin e një shoqate të ndërmarrjeve ose praktikës së bashkërenduar të ndërmarrjeve.

KREU 2 PËRJASHTIMET DHE LIRIMET

Marrëveshjet e përjashtuara Neni 4

Ndalimi i nenit 3.1 nuk zbatohet edhe për:

- a. një marrëveshjet ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve, nëse ndërmarrjet e tilla përbëjnë ose janë pjesë e një njësie të vetme ekonomike, edhe nëse ndërmarrjet në fjalë nga pikpamja ligjore janë të ndryshme. Në veçanti, marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjes amë dhe degëve të saj, ose dy degëve që kanë një ndërmarrje amë të përbashkët, nuk u nënshtrohen ndalimeve të nenit 3.1 nëse degët në fjalë nuk kanë liri të vërtetë që pavarësisht të vendosin për rrjedhën e aktiviteteve të tyre në treg; ose
- b. një marrëveshje që ka për qëllim të ndikojë në shkrirjen e dy ndërmarrjeve; me kusht që, sidoqoftë, ky përjashtim të vlejë vetëm për dispozitat e asaj marrëveshjeje që janë drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme për kryerjen e shkrirjes.

Përjashtimi për marrëveshjet mbi zbatimin e njëjlojshëm të standardeve
ose kushteve biznesore.

Neni 5

KKK-ja mund të përjashtojë një marrëveshje nga ndalimi i nenit 3.1 nëse lënda në fjalë si pasojë shprehimisht ka të bëjë me zbatimin e njëjlojshëm të:

- a. standardeve; ose
- b. afarizmit të përgjithshëm, afateve dhe kushteve të dërgesave dhe pagesave, duke përfshirë zbritje për pagesat me para në dorë; me kusht që, sidoqoftë, marrëveshja ose vendimi i tillë të mos ketë të bëjë në asnjë mënyrë me çmimet ose elementet e çmimeve.

Përjashtimi i marrëveshjeve për specializim

Neni 6

KKK-ja mund të përjashtojë një marrëveshje nga ndalesat e nenit 3.1 nëse lënda e marrëveshjes në fjalë mirret vetëm me racionalizimin e aktiviteteve ekonomike përmes specializimit dhe nëse marrëveshja e tillë i përmbush kriteret në vijim:

- a. përfitimet publike ekonomike, veçanërisht përfitimet ekonomike të konsumatorit, që me arsye pritet se do të dalin nga racionalizimi në fjalë, janë thelbësore dhe qartësisht kanë më shumë peshë se të gjitha efektet negative ekonomike që mund të lindin nga kufizimi i konkurrencës i shkaktuar nga marrëveshja në fjalë;
- b. marrëveshja e tillë nuk vendos në ndërmarrjet përkatëse kurrfarë kufizime që nuk janë të domosdoshme për arritjen e racionalizimit në fjalë;
- c. kufizimi i konkurrencës i shkaktuar në këtë mënyrë, nuk shpie drejt krijimit ose përforcimit të një pozicioni zotërues; dhe
- d. marrëveshja ose vendimi i tillë nuk ju krijon ndërmarrjeve përkatëse mundësinë e zhdukjes së konkurrencës për një pjesë të rëndësishme artikujve përkatës.

Përfashtimi për marrëveshjet e racionalizimit
Neni 7

KKK-ja mund të përjashtojë një marrëveshje nga ndalimet e nenit 3.1 nëse marrëveshja e tillë qartësisht shërben për racionalizimin e aktiviteteve ekonomike duke e rritur frytshmërinë ose prodhimtarinë e ndërmarrjeve pjesëmarrëse nga pikëpamja teknologjike, komerciale ose organizative, dhe nëse marrëveshja e tillë i plotëson kriteret në vijim:

- a. marrëveshja e tillë me arsye pritet se do të përmirësojë dukshëm përmbushjen e kërkesave;
- b. përfitimet publike ekonomike, veçanërisht përfitimet ekonomike të konsumatorit, që me arsye pritet se do të dalin nga racionalizimi në fjalë, janë thelbësore dhe qartësisht kanë më shumë peshë se të gjitha efektet negative ekonomike që mund të lindin nga kufizimi i konkurrencës i shkaktuar nga marrëveshja në fjalë;
- c. marrëveshja në fjalë synon të arrijë racionalizimin përmes shfrytëzimit të një organizate të përbashkët blerëse ose shitëse, ka dëshmi bindëse për të provuar se racionalizimi i dëshiruar nuk mund të arrihet në asnjë mënyrë tjetër;
- d. kufizimi i konkurrencës i krijuar në këtë mënyrë nuk i hapë rrugë krijimit ose përforcimit të një pozicioni dominues;
- e. marrëveshja e tillë nuk vendos në ndërmarrjet përkatëse kurrfarë kufizimesh që nuk janë saktësisht të domosdoshme për arritjen e racionalizimit në fjalë; dhe
- f. marrëveshja në fjalë, nuk ju siguron ndërmarrjeve përkatëse mundësinë e zhdukjes së konkurrencës për një pjesë të rëndësishme të artikujve përkatës.

Përfashtimi i marrëveshjeve të tjera të caktuara
Neni 8

KKK-ja mund të përjashtojë një marrëveshje nga ndalesat e nenit 3.1 nëse marrëveshja e tillë do të kontribuojë në masë të madhe për përmirësimin e zhvillimit, prodhimin, shpërndarjes, prokurimit, shitjes së lirë ose asgjësimit të artikujve përkatës, dhe marrëveshja e tillë i përmbush kriteret në vijim:

- a. marrëveshja në fjalë me arsye mund të pritet se do të rezultojë në përfitime ekonomike të konsiderueshme për konsumatorët e artikujve përkatës;
- b. përfitimet publike ekonomike, veçanërisht përfitimet ekonomike të konsumatorit, që me arsye pritet se do të dalin nga racionalizimi në fjalë, janë të mëdha dhe qartë i kalojnë për nga pesha të gjitha efektet negative ekonomike që mund të lindin nga kufizimi i konkurrencës i shkaktuar nga marrëveshja në fjalë;
- c. përmirësimi i tillë nuk mund të arrihet nga ndërmarrjet pjesëmarrëse në asnjë mënyrë tjetër;
- d. kufizimi i konkurrencës së krijuar në këtë mënyrë nuk i hapë rrugë shkaktimit ose përforcimit të një pozicioni zotërues;
- e. marrëveshja e tillë nuk vendos në ndërmarrjet përkatëse kurrfarë kufizimesh që nuk janë të domosdoshme për arritjen e racionalizimit në fjalë;
- f. marrëveshja në fjalë, nuk ju siguron ndërmarrjeve përkatëse mundësinë e zhdukjes së konkurrencës për një pjesë të madhe të artikujve përkatës.

Aplikimi dhe lejimi i përjashtimit
Neni 9

9.1. KKK-ja mund të lejojë një përjashtim të specifikuar në nenet 5, 6, 7 ose 8 për një marrëveshje të veçantë nëse KKK-ja (i) ka pranuar një aplikim për përjashtimin në fjalë që plotësisht përputhet me kërkesat e nenit 9.2, (ii) ka shqyrtuar aplikimin në fjalë dhe i ka hetuar çështjet e parashtruara në të, dhe (iii) ka konstatuar se kriteret për lejimin e përjashtimit janë përmbushur.

9.2. Aplikimi për përjashtim duhet të përmbajë sa vijon:

- a. emrat dhe adresat e regjistruara të ndërmarrjeve pjesëmarrëse;
- b. emrin, adresën dhe njoftimet e kontaktimit të personit fizik i cili është autorizuar formalisht nga ndërmarrjet pjesëmarrëse për t'i përfaqësuar ato në lidhje me aplikimin;
- c. një kopje të marrëveshjes përkatëse; dhe
- d. një shpjegim të hollësishëm që provon se kriteret për lejimin e përjashtimit përkatës janë përmbushur.

9.3. Aplikimi duhet të jetë i plotë dhe nuk duhet të përmbajë në thelb informacione të pasakta dhe mashtruese. KKK-ja mund të kërkoj, dhe ndërmarrjet pjesëmarrëse duhet të sigurojnë, informacione të tilla shtesë dhe materialet e tjera të kërkuara nga KKK-ja.

9.4. Pas pranimit të aplikimit për përjashtim, KKK-ja do të shqyrtojë aplikimin në fjalë dhe do të bëjë hetimin e çështjeve të parashtruara në të. Gjatë zhvillimit të hetimeve, KKK-ja do të kërkoj komente nga publiku dhe, në veçanti, nga konsumatorët dhe ndërmarrjet që ndikohen nga këto aktivitete.

9.5. Nëse KKK-ja konstaton se kriteret për përjashtimin e kërkuar nuk janë përmbushur, KKK-ja duhet të refuzojë aplikimin dhe zyrtarisht t'i njoftojë me shkrim për konstatimin e tillë ndërmarrjet pjesëmarrëse.

9.6. Nëse KKK-ja vendos që kriteret për përjashtimin e kërkuar janë përmbushur, KKK-ja do t'ju dërgojë zyrtarisht ndërmarrjeve pjesëmarrëse një instrument me shkrim duke ju lejuar përjashtimin në fjalë. Përjashtimi do të hyjë në fuqi vetëm pasi që KKK-ja t'u ketë dërguar zyrtarisht instrumentin në fjalë ndërmarrjeve pjesëmarrëse.

9.7. KKK-ja mund të kushtëzojë një përjashtim me çfarëdo kushti dhe/ose obligimi që KKK-ja e konsideron të lejueshëm. KKK-ja duhet që t'i përcaktojë qartë kushtet dhe/ose obligimet e tilla në instrumentin me shkrim me të cilin e lejon përjashtimin në fjalë.

9.8. KKK-ja do të përcaktojë qartë një periudhë të caktuar kohore gjatë të cilës përjashtimi duhet të mbetet në fuqi. KKK-ja mund të përcaktojë qartë çfarëdo periudhe kohore që ajo e konsideron të përshtatshme; sidoqoftë, periudha në fjalë nuk duhet të tejkalojë tri (3) vite. KKK-ja do të përcaktojë qartë periudhën e tillë kohore në instrumentin me të cilin lejohet përjashtimi.

9.9. KKK-ja mund ta anulojë, ndryshojë ose të cakttojë kushte dhe/ose obligime në një përjashtim më parë të lejuar, nëse KKK-ja konstaton se:

- a. rrethanat lidhur me përjashtimin në pjesën më të madhe kanë ndryshuar;
- b. një ose më shumë ndërmarrje pjesëmarrëse nuk e kanë plotësuar kushtin ose obligimin nga i cili varej përjashtimi;

- c. përjashtimi ishte siguruar në bazë të informatave jo të plota ose në thelb të pasakta apo mashtruese;
- d. një ose më shumë ndërmarrje pjesëmarrëse e kanë shpërdoruar përjashtimin ose pozitën në treg të arritur si përfundim i përjashtimit; ose
- e. marrëveshja për të cilën vlen përjashtimi është duke u zbatuar në atë mënyrë që përbën shpërdorim të pozitës në treg të arritur si përfundim i përjashtimit.

PJESA III MARRËVESHJET VERTIKALE

Ndalimi themelor në marrëveshjet që kufizojnë lirinë e palëve për caktimin e çmimeve dhe kushteve në transaksionet me palët e treta

Neni 10

Marrëveshja ndërmjet ndërmarrjeve lidhur me mallra dhe/ose shërbime dhe që ndikon në një treg brenda Kosovës është e ndaluar për aq sa ajo e kufizon lirinë e palës për vendosjen e çmimeve në ngarkim të palëve të treta ose çfarëdo kushti thelbësor në marrëveshjet e lidhura me palët e treta.

Kontrollimi i shpërdorimit të transaksioneve ekskluzive tregtare

Neni 11

Marrëveshja ndërmjet ndërmarrjeve që përfshin mallrat ose shërbimet dhe që vendos mbi një palë (i) një kufizim të lirisë së shfrytëzimit të mallrave të furnizuara ose të mallrave ose shërbimeve të tjera; (ii) një kufizim të lirisë së blerjes ose shitjes së mallrave dhe/ose shërbimeve të tjera nga/për palët e treta; (iii) një kufizim mbi lirinë e shitjes së mallrave të furnizuara palëve të treta; ose (iv) një obligim për blerjen e mallrave ose shërbimeve që, nga karakteri i tyre ose praktika e zakonshme komerciale, nuk kanë të bëjnë me lëndën themelore të marrëveshjes në fjalë, ndalohen nëse kufizimet dhe/ose obligimet tilla dukshëm e dëmtojnë tregun e mallrave dhe/ose shërbimeve përkatëse.

Marrëveshjet mbi pronën intelektuale dhe sekretin afarist

Neni 12

12.1. Marrëveshja për shitjen ose licënsimin e të drejtave të pronës intelektuale apo sekretit afarist ndalohet gjer në atë masë sa vendos kufizime ndaj veprimtarive ekonomike të blerësit ose licënsëmarrësit që nuk kanë të bëjnë me shfrytëzimin ose mbrojtjen e të drejtave përkatëse apo sekretit. Kufizimet që ju përkasin natyrës, shkallës, sferës teknike të zbatimit, sasisë, territorit ose kohës së ushtrimit ose të shfrytëzimit të të drejtës në fjalë nuk do të konsiderohet se nuk kanë të bëjë me shfrytëzimin ose mbrojtjen e të drejtës në fjalë apo sekretit.

12.2. Marrëveshjet që bien brenda sferës së nenit 12.1. përfshijnë:

- a. marrëveshjen për shitjen ose licënsimin e patentës ose modelit praktik-qoftë të dhënë ose të kërkuar-ose topografinë e qarkut të mbyllur të mbrojtur me ligj ose modifikimet gjenetike të farës.

- b. marrëveshjen për shitjen ose liçensimin e, me ligj të pambrojtura, zbulimeve, metodave të përpunimit, projekteve, arritjeve tjera që çojnë përpara teknologjinë, arritjeve që çojnë përpara kultivimin e bimëve në lëmin e rritjes së bimëve, për aq sa ato përfaqësojnë sekrete të rëndësishme afariste dhe janë njejtësuar në mënyrë mjaft të arsyeshme në marrëveshje.
- c. Marrëveshjen e përzier për shitjen ose liçensimin e të dyjave të drejtës së mbrojtur të trajtuar në paragrafin “a” më lartë dhe një arritje të pambrojtur të trajtuar në paragrafin “b” të sipërtheksuar; dhe
- d. Marrëveshjen për shitjen ose liçensimin e qoftë të të drejtave të pronës intelektuale siç janë e markat tregtare, modelet e depozituara, të drejtat autoriale (përfshirë programet kompjuterike), për aq sa kjo marrëveshje lidhet me marrëveshjen për të drejtën e mbrojtur të përfshirë në paragrafin “a” të lartë theksuar, ose një arritje të pambrojtur në kuptim të paragrafit “b” të lartë theksuar, apo me një marrëveshje të përzier në kuptim të paragrafit “c” të lartë theksuar, dhe ndihmon për arritjen e qëllimit kryesor të shitjes ose liçensimit të drejtave të pronës intelektuale ose arritjeve të pambrojtura.

12.3. Me kusht që afati i kufizimit në fjalë ose obligimit nuk e kapërcen afatin e të drejtës të mbrojtur nga ana ligjore, neni 12.1 nuk vlen për një marrëveshje që vendos mbi blerësin ose liçencësmarrësin e të drejtës së mbrojtur nga ana ligjore;

- a. kufizim në aftësinë e tij për të shfrytëzuar të drejtën e mbrojtur, për aq sa kufizimi i tillë arsyetohet me interesin e ligjshëm të shitësit ose licensëdhënësit për shfrytëzimin e pranueshëm teknik të objektit të të drejtës së mbrojtur;
- b. një obligim për të shkëmbyer informacionet mbi përvojat pasuese ose për dhënien e licensave të zakonshme në lidhje me inovacionet, përmirësimet ose kërkesat e reja, me kusht që secili obligim i tillë të përputhet me obligimin e ngjashëm nga ana e shitësit ose licensëdhënësit;
- c. një obligim për të mos kundërshtuar vlefshmërinë e të drejtës që është licensuar ose fituar;
- d. një obligim për ta shfrytëzuar sa më pak të drejtë drejtën e mbrojtur me licensë ose për të paguar taksë minimale; ose
- e. një obligim për të shpifur ndaj produkteve të licensuara në një mënyrë të caktuar, me kusht që obligimi i tillë mos të parasheh që shpifja të përjashtojë referimin e prodhuesit.

12.4. KKK-ja mund të lejojë përjashtim për një marrëveshje e cila përndryshe ndalohet me nenin 12.1 nëse KKK-ja ka (i) pranuar një kërkesë për një përjashtim të tillë nga njëra prej palëve të interesuara, (ii) ka shqyrtuar kërkesën e tillë dhe i ka hulumtuar çështjet e paraqitura në të; dhe (iii) ka konstatuar se liria ekonomike e blerësit ose licensëmarrësit ose ndërmarrjeve tjera nuk është kufizuar në mënyrë të padrejtë si rrjedhim, dhe se me këtë konkurrenca në tregun përkatës nuk është dëmtuar.

PJESA IV
SHPËRDORIMI I POZITËS DOMINUESE DHE PRAKTIKA E TJERA KUFIZUESE

KREU 1
SHPËRDORIMI I POZITËS DOMINUESE

Ndalimi i shpërdorimit të pozitës dominuese
Neni 13

Ndalohet shpërdorimi i pozitës dominuese nga një ose më shumë ndërmarrje.

Konstatimi i ekzistimit të pozitës dominante
Neni 14

14.1. Ndërmarrja ka pozitë dominuese nëse, si furnizuese ose blerëse e disa llojeve të caktuara të mallrave ose shërbimeve: ajo

- a. nuk i nënshtrohet konkurrencës së vertetë; ose
- b. ka fuqi superiore në treg në krahasim me konkurrentët e saj ekzistues ose potencial; për këtë qëllim, do të mirret parasysh veqanërisht pjesëmarrja dhe pozita e saj në tregun përkatës, fuqia e saj financiare, qasja e saj ndaj furnizimeve ose tregjeve, lidhjet e saj me ndërmarrjet e tjera, pengesat juridike ose faktike për hyrjen e ndërmarrjeve të tjera në treg, konkurrenca aktuale ose potenciale me ndërmarrjet e themeluara brenda ose jashtë Kosovës, lehtësia ose vështirësia me të cilën ajo mund të ndryshojë furnizimin e mallrave ose shërbimeve të tjera si dhe aftësitë e furnizuesve ose klientëve të saj që të zhvillojnë afarizëm me ndërmarrje të tjera.

14.2. Një ndërmarrje konsiderohet të ketë pozitë dominuese nëse ka pjesëmarrje më të madhe se 40% në treg. Ky konsiderim nuk është i aplikueshëm në rast se ndërmarrja në fjalë bindshëm demonstroi se është e ekspozuar para një konkurrence të konsiderueshme ose që nuk ka pozitë superiore në treg në krahasim me konkurrentët e vet, duke i marrur parasysh faktorët e specifikuar në nenin 14.1.b.

14.3. Dy ose më shumë ndërmarrje kanë pozitë dominuese nëse, si blerës ose shitës të disa llojeve të caktuara të mallrave ose shërbimeve, nuk ekziston konkurrencë e fortë ndërmjet tyre, dhe ato:

- a. nuk i nënshtrohen konkurrencës së vërtetë; ose
- b. së bashku kanë fuqi superiore në treg në krahasim me konkurrentët e tyre, duke marrë parasysh faktorët e specifikuar në pikën b të nenit 14.1.b.

14.4. Dy apo më shumë ndërmarrje konsiderohet të kenë pozitë dominuese nëse kanë pjesëmarrje të përbashkët më të madhe se 40% në treg. Pesë ndërmarrje apo më pak konsiderohet të kenë pozitë dominuese nëse kanë pjesëmarrje të përbashkët prej së paku 70% në treg. Ky konsiderim i bazuar në këtë paragraf 14.4 nuk është i aplikueshëm në rast se ndërmarrjet në fjalë bindshëm demonstrojnë se kushtet e konkurrencës kërkojnë që ato të mbajnë konkurrencë të konsiderueshme ndërmjet veti ose që nuk kanë bashkarisht pozitë superiore në treg në krahasim me konkurrentët tjerë që i kanë, duke i marrur parasysh faktorët e specifikuar në nenin 14.1.b.

Konstatimi i shpërdorimit të pozitës dominuese

Neni 15

Shpërdorimi i ndaluar i pozitës dominuese ekziston nëse, si furnizues ose blerës i disa llojesh të caktuara të mallrave ose shërbimeve, një ose më shumë ndërmarrje më pozitë dominuese:

- a. ndikon negativisht në konkurrencën e tregut duke dëmtuar aftësinë e ndërmarrjeve tjera për konkurrim në treg;
- b. kërkon pagesa ose kushte të tjera afariste që dallojnë nga ato që ka shumë të ngjarë se do të mbizotëronin po të kishte konkurrencë efektive, në këtë kontekst, do të mirret parasysh sjellja e ndërmarrjeve në tregjet e krahasueshme që karakterizohen me konkurrencë efektive;
- c. kërkon pagesa më pak të favorshme ose kushte të tjera afariste nga ç'kërkon prej blerësve të ngjajshëm në tregje të krahasueshme, përveç nëse ka arsyetim objektiv për dallimin e tillë;
- d. refuzon që t'ju lejojë ndërmarrjeve tjera, si kompensim për shfrytëzimin e arsyeshëm, përdorimin e rrjetave ndërlidhëse dhe infrastrukturës së saj, nëse shfrytëzimi i përbashkët ose qasja e tillë kërkohet nga këto ndërmarrje tjera, për arsye juridike ose faktike, që të veprojnë si konkurrent i ndërmarrjes dominuese; sidoqoftë, kjo nuk do të përbëjë shpërdorim nëse ndërmarrja dominuese bindshëm dëshmon se për arsye teknike, operacionale ose arsye të tjera, lejimi i shfrytëzimit të përbashkët ose qasjes është i pamundshëm ose nga ana tregtare jo i besueshëm; ose
- e. shfrytëzimi i pozitës në treg për të krijuar ndërmarrje tjera që i dhurojnë atij qëllime privilegjuese, përveç nëse qëllimi është i arsyeshëm për një trajtim të tillë favorizues.

KREU 2

PRAKTIKAT E TJERA KUFIZUESE

Ndalimi i Diskriminimit, Ndalimi i Pengimit të Padrejtë

Neni 16

16.1. Një ndërmarrje dominuese, një shoqëri e ndërmarrjeve ose një ndërmarrje që i cakton çmimet me pakicë nuk e pengon drejtpërsëdrejti apo tërthorazi një ndërmarrje tjetër në aktivitetet e saja afariste, ose drejtpërsëdrejti apo tërthorazi të trajtojë atë ndryshe nga ndërmarrjet tjera të ngjashme, përveç nëse ekziston arsyetimi objektiv për trajtimin e tillë.

16.2. Neni 16.1 do të vlejë edhe për ndërmarrjet dhe shoqëritë e ndërmarrjeve në të cilat ndërmarrjet e vogla ose të mesme, si furnizues ose blerës të mallërave ose shërbimeve të caktuara, varen në atë mënyrë që të mos ekzistojë ndonjë mundësi e arsyeshme për t'iu drejtuar ndërmarrjeve tjera. Një furnizues i një malli apo shërbimi të caktuar do të konsiderohet si i varshëm në një blerës në rast se blerësi i tillë merrë beneficione të veçanta nga furnizuesi i tillë të cilat nuk u ipen blerësve tjerë të ngjashëm.

16.3. Ndërmarrjet dhe shoqëritë e ndërmarrjeve dominuese nuk e shfrytëzojnë pozitën e tyre në treg për të kërkuar nga ndërmarrjet tjera kushte preferuese, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive për kushte të tilla.

16.4. Një ndërmarrje që ka fuqi superiore në treg në krahasim me konkurrentët e vegjël apo të mesëm, nuk do të shfrytëzon fuqinë e saj në treg për të penguar drejtpërsëdrejti apo tërthorazi konkurrentët e tillë në mënyrë të padrejtë. Një pengim i tillë ekziston posaçërisht kur një ndërmarrje, pa arsye objektive, ofron mallra ose shërbime, më shpesh se kohë pas kohe, me çmim që është më i ulët se çmimi i një malli apo shërbimi të tillë.

16.5. Shoqëritë e ndërmarrjeve, organizatat profesionale ose organizatat e markës cilësore nuk do të refuzojnë antarsimin e një ndërmarrje në rast se një refuzim i tillë e vënë ndërmarrjen në pozitë të pafavorshme dhe në rast se nuk ka arsye objektive për një refuzim të tillë.

Ndalimi i bojkotimeve dhe praktikave të tjera kufizuese Neni 17

17.1. Asnjë person ose ndërmarrje nuk duhet të kërkojë nga një person ose ndërmarrje tjetër që të refuzojë shitjen ose blerjen, me qëllim të dëmtimit të një personi ose ndërmarrje tjetër.

17.2. Asnjë person ose ndërmarrje nuk duhet të kërcënojë ose t'i shkaktojë dëme, ose të premtojë apo t'i japë përparësi, një personi ose ndërmarrjeje për t'i nxitur ato që të zhvillojnë aktivitete të ndaluara me këtë ligj.

17.3. Asnjë person ose ndërmarrje nuk duhet të kërcënojë apo t'i shkaktojë asnjë lloj dëmi një personi ose ndërmarrje tjetër në mënyrë që të nxisë personin ose ndërmarrjen që të mos e dorëzojë një ankese ose të vazhdojë ankimin e dorëzuar në KKK ose në një Gjykatë përkatëse të Qarkut, që përmban supozim të shkeljeve të këtij ligji.

17.4. Asnjë person ose ndërmarrje nuk duhet të marrë çfarëdo masash me qëllim të detyrimit të një ndërmarrje ose shoqate të ndërmarrjeve që:

- a. të pranojnë një marrëveshje ose vendim sipas dispozitave të pjesës II të këtij ligji;
- b. të pranojnë bashkimin me një ndërmarrje tjetër; ose
- c. të ndërmarrin masa të përmbashkëta në treg me qëllim të kufizimit të konkurrencës.

Ndalimi i rekomandimeve Neni 18

18.1. Asnjë ndërmarrje ose shoqatë e ndërmarrjeve nuk duhet të bëjë rekomandime që kanë për qëllim ose ndikojnë në shmangien e një ndalimi të vendosur nga ky ligj.

18.2. Asnjë ndërmarrje ose shoqatë e ndërmarrjeve nuk duhet t'i bëjë rekomandime blerësve të mallrave për të kërkuar ose ofruar çmime të caktuara gjatë rishitjes palëve të treta, për përdorimin e metodave të caktuara të vendosjes së çmimeve, ose të ruajtjes së çmimeve të caktuara më larta ose më të ulëta.

Rekomandimet jodetyruese të çmimeve për produktet e markës
Neni 19

19.1. Neni 18.2 nuk do të zbatohet për rekomandimet e padetyrueshme të çmimeve të një ndërmarrjeje për ri-shitjen e produkteve të saj të markës që janë në konkurrencë të vërtetë të çmimeve me mallrat e ngjajshme të prodhuesve të tjerë, me kusht që rekomandimet e tilla:

- a. janë emërtuar shprehimisht si jodetyruese, tregojnë vetëm një çmim të caktuar si dhe nuk zbatohet kurrfarë trysnie ekonomike, sociale ose trysni tjetër për ekzekutimin e tyre; dhe
- b. janë nxjerrë me parashikimin se çmimi i rekomanduar do t'i përgjigjet çmimit që ka të ngjarë se do të arkëtohet nga shumica marrësve të rekomandimit.

19.2. Mallrat me markë, përbrenda kuptimit të nenit 19.1, janë produkte (i) furnizimi i të cilave, me cilësi të qëndrueshme apo të përmirësuar, garantohet nga ndërmarrja që rekomandon çmimin, dhe (ii) që e kanë markën (një simbol, markë tregtare ose fjalë) ku ceket prejardhja, furnizuesi, ose prodhuesi i tyre, e cila vihet (a) në produkt (b) në ambalazhin me të cilin produkti i ofrohet konsumatorit, ose (c) në kontenjerë prej të cilëve konsumatorit i shitet malli.

19.3. KKK-ja mund të shpallë që rekomandimi i llojit të përshkruar në nenin 19.1 të jetë i papranueshëm dhe mund t'i ndalojë rekomandimet e reja dhe të ngjajshme nëse KKK-ja vërteton se rekomandimet përbëjnë shpërdorim të përjashtimeve të përcaktuara me nenin 19.1. Një shpërdorim i tillë ekziston, veçanërisht, nëse:

- a. rekomandimi ose lidhja e tij me kufizimet e tjera të konkurrencës mund të ngritë çmimin e mallrave ose të parandalojë rënien e çmimeve të tyre ose do të kufizojë prodhimin ose shitjen e tyre;
- b. rekomandimi mund t'i mashtrtojë konsumatorët sa i përket çmimit të kërkuar nga shumica e marrësve të rekomandimit;
- c. çmimi i rekomanduar, në shumicën e rasteve, i tejkalon së tepërmi çmimet aktuale të kërkuara në Kosovë ose në pjesën më të madhe të saj, ose
- d. ndërmarrje të caktuara ose grupe të caktuara të blerësve përjashtohen nga shpërndarja e mallrave përmes transaksioneve të shpërndarjes ose masave të tjera të marra nga ndërmarrja rekomanduese pa ndonjë arsytim objektiv.

PJESA V
KOMISIONI KOSOVAR I KONKURRENCËS
KREU 1
THEMELIMI, FUNKSIONET DHE ORGANIZIMI

Themelimi i Komisionit Kosovar të Konkurrencës
Neni 20

20.1. Në përputhshmëri me nenin 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/9 do të themelohet një organ i pavarur rregullativ i konkurrencës që mund të njihet si Komisioni Kosovar i Konkurrencës (KKK-ja). KKK-ja ka përgjegjësinë dhe autoritetin për zbatimin e këtij ligji dhe promovimin e konkurrencës ndërmjet ndërmarrjeve dhe mbrojtjen e konsumatorëve në Kosovë.

20.2. KKK-ja do të ketë personel të mjaftueshëm ndihmës për t'i mundësuar asaj që në mënyrë efikase dhe profesionale t'i ushtrojë funksionet e specifikuar në nenin 20.1.

Funksioni kontrollues Neni 21

Përveç funksioneve që i janë dhënë asaj në dispozitat tjera të këtij ligji, KKK-ja është e autorizuar dhe përgjegjëse për të kontrolluar kushtet e konkurrencës në ekonominë e Kosovës si dhe në sektorë, industri dhe tregje të veçanta.

Funksionet e hetimit dhe ekzekutimit Neni 22

Në mënyrë që t'i ushtrojë funksionet e dhëna me këtë ligj, KKK-ja do të ketë autorizime hetuese të specifikuar në Kapitullin 2 të kësaj Pjese V. KKK-ja gjithashtu do të ketë autorizime të ekzekutimit të përshkruara më hollësisht në Pjesën VI.

Funksioni i akteve nënligjore Neni 23

23.1. KKK-ja do të hartoj, miratoj dhe publikoj akte të hollësishme nënligjore për zbatimin e këtij ligji. Nëse me ndonjë dispozitë të këtij ligji në mënyrë të qartë kërkohet nga KKK-ja që të hartoj, miratoj dhe publikoj akte nënligjore që zbatohen ose përfshijnë çështjen që është objekt i dispozitës në fjalë, KKK-ja është posaçërisht e obliguar që t'i hartoj, miratoj dhe publikoj aktet në fjalë. Nëse një dispozitë e këtij ligji nuk e kërkon në mënyrë të qartë një gjë të tillë, atëherë KKK-ja, nëse dhe për aq sa e konsideron të nevojshme, do të hartoj, miratoj dhe publikoj akte nënligjore që zbatohen ose mbulojnë lëndën e dispozitës përkatëse. KKK-ja gjithashtu është e autorizuar që të hartoj, miratoj, dhe publikoj akte nënligjore që bienë arsyetimisht në fushëveprimin e këtij ligji por që nuk mbulohen qartë nga dispozitat e këtij ligji.

23.2. Të gjitha aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji do të jenë (i) në përputhshmëri me fushëveprimin, gjuhën, dhe qëllimin e këtij ligji, dhe (ii) në përputhshmëri me ligjin dhe praktikën e Unionit Europian që kanë të bëjnë me lëmi të ngjashme.

Funksionet tjera Neni 24

24.1. Përveç çështjeve të specifikuar më lartë, KKK-ja:

- a. do të japë njoftime dhe udhëzime mbi kërkesat e këtij ligji për personat, ndërmarrjet dhe autoritetet publike;
- b. do të organizojë seminare dhe kurse trajnimi me qëllim njoftimi të personave, e veqanërisht juristëve dhe ekonomistëve profesionist, ndërmarrjeve mbi të drejtat, obligimet dhe çështjet që janë objekt i rregullimit dhe/ose i përfshirjes në këtë ligj;

- c. për çdo vit kalendarik, do të përgatisë, publikoj dhe dorëzoj Kuvendit një raport vjetor (i) duke i analizuar kushtet konkurruese në ekonominë e përgjithshme të Kosovës si dhe në sektorë të veçantë, industri dhe tregje, dhe (ii) duke i përmbledhur të gjitha masat hetimore dhe të ekzekutimit që KKK-ja i ka ndërmarrë gjatë vitit kalendarik në fjalë, me kusht që raporti në fjalë të mos përfshijë asnjë referencë lidhur me hetimin që është në vazhdim e sipër, deri në atë mase sa referenca e tillë do të rrezikonte fshehtësinë ligjore të hetimit të tillë. Raporti i tillë vjetor duhet të publikohet dhe dorëzohet Kuvendit deri në fund të Shkurtit të çdo viti pasues kalendarik; dhe
- d. Do të përgatisë, publikoj dhe dorëzoj Kuvendit, së bashku me raportin vjetor, të gjitha rekomandimet që KKK-ja mund t'i ketë për përmirësimin e këtij ligji.

24.2. Komisionet e Kuvendit në fjalë, pasi të pranojnë raportin dhe rekomandimet e specifikuar në nenin 24.1 (c) dhe (d), ose pas kalimit të afatit të dorëzimit të tyre, do të mbajnë dhe të udhëheqin një ose më tepër ndëgjime me anëtarët e dhe personelin e KKK-së për të diskutuar në lidhje me raportin dhe rekomandimet. Në ndëgjimet e tilla mund të përfshihen edhe çështje tjera në lidhje me veprimtaritë e KKK-së.

24.3. Personat dhe ndërmarrjet e interesuara do të kenë të drejtën t'u sigurojnë komisioneve përkatëse pikëpamjet e tyre me shkrim në lidhje me raportet dhe/ose rekomandimet e tilla si dhe mbi çështjet tjera që lidhen me veprimtaritë e KKK-së. Një person apo ndërmarrje e tillë mund të paraqesë pikëpamjet e veta edhe gojarisht, nëse për këtë ftohet nga komisioni përkatës.

Emërimi i anëtarëve Neni 25

25.1. KKK-ja përbëhet nga pesë (5) anëtarë. Të gjithë anëtarët emërohen në bazë të nenit 25.

25.2. Secili anëtar i KKK-së, në momentin e emërimit të tyre, e merr statusin e shërbyesit civil dhe nuk do t'i nënshtrohet largimit apo suspendimit para se t'i skadojë mandati, përveç (i) përmes një urdhëri të lëshuar nga Kuvendi në bazë të nenit 28 të këtij ligji, (ii) në pajtim me procedurat e themeluara me Ligjin mbi Shërbimin Civil.

25.3. Anëtarët e KKK-së emërohen nga Kuvendi. Qeveria themelon një komision profesional të pavarur për të identifikuar dhe intervistuar individët që janë kandidatë potencial për anëtarësi në KKK. Komisioni në fjalë do të pranojë aplikacionin dhe do të intervistoj të gjithë personat e interesuar. Komisioni në fjalë do të hartoj dhe dorëzojë Qeverisë një listë që përmban emrat e 10 kandidatëve që Komisioni i ka konstatuar si më të kualifikuarit. Qeveria do të ia dorëzojë Kuvendit listën në fjalë së bashku me të gjitha dokumentacionet përcjellëse mbi kandidatët dhe punën e Komisionit. Komisionet përkatëse të Kuvendit do t'i intervistojnë prapë 10 kandidatët dhe së bashku do t'i zgjedhë dhe propozoj Kuvendit të gjithë 5 kandidatët me të kualifikuar. Kandidati duhet të marrë shumicë votash në Kuvend në mënyrë që të emërohet. Kuvendi ka të drejtë të refuzojë cilindo ose të gjithë kandidatët e paraqitur nga Qeveria dhe të kërkojë nga Qeveria që të përgatisë dhe dorëzojë një listë të re me emrat e kandidatëve të tjerë. Nëse Qeveria nuk i përmbush detyrimet e parapara me nenin 25.3 brenda 90 ditëve, Komisionet përkatëse të Kuvendit mundën që në mënyrë të pavarur të identifikojnë, intervistojnë dhe rekomandojnë kandidatët para Kuvendit.

25.4. Asnjë person nuk mund të emërohet ose të shërbejë si anëtar i KKK-së nëse ai/ajo:

- a. ka interesa pronësore ose marrëdhënje të punës ose kontraktuese me një ndërmarrje ose një shoqatë të ndërmarrjeve të themeluar në Kosovë ose që mirret me aktivitete ekonomike që kanë ndikim në Kosovë;
- b. është anëtar i një bordi menaxhues ose mbikëqyrës të një ndërmarrjeje ose shoqate të ndërmarrjeve të specifikuar në pikën “a”;
- c. është vendosur nga një gjykatë kompetente se ka bërë shkelje penale ose civile duke përfshirë aktivitete të korrupsionit, larjen e parave, mito ose ryshfet sipas ligjeve ose rregulloreve në fuqi në Kosovë ose kudo tjetër;
- d. është vendosur kohë më parë nga një gjykatë kompetente se ka bërë shkelje të rëndë duke marrë pjesë në aktivitetet e një organizate kriminale, që përkufizohet si organizatë e strukturuar e cila është themeluar gjatë një periudhe kohore dhe që vepron në mënyrë të bashkuar për të arritur përfitime financiare përmes ushtrimit të aktiviteteve që janë kriminale ose përndryshe të paligjshme në vendin ku ato ushtrohen.
- e. është vendosur nga një gjykatë kompetente se ka kryer një vepër të mashtrimit ose një vepër të barasvlershme më mashtrimin; ose
- f. një gjykatë kompetente, organ administrativ ose organizatë përgjegjëse për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale ka vendosur se ka bërë sjellje joprofesionale.

25.5. Mandati i pesë anëtarëve të parë të KKK-së është si vijon: një anëtar emërohet për një vit, dy anëtarë emërohen për tri (3) vite dhe dy anëtarë të tjerë emërohen për pesë (5) vite. Pasardhësit e tyre emërohen për mandat prej pesë (5) viteve.

25.6. Të gjithë anëtarët e KKK-së duhet të posedojnë diplomë të vlefshme universitare dhe të mos diskualifikohen sipas nenit 25.4.

25.7. Njëri nga anëtarët e KKK-së duhet ti posedojë kualifikimet e njëjta si ato që kërkohet sipas ligjit të zbatueshëm për emërimet të gjykatësve.

25.8. Tre anëtarë të KKK-së duhet të jenë ekonomistë profesionistë që (i) posedojnë diploma të avancuara universitare që dëshmojnë trajnim substancial akademik në ekonominë e tregut dhe (ii) kanë përvojë substanciale në analiza mikro-ekonomike.

25.9. Një anëtar i KKK-së duhet të ketë trajnim profesional ligjor si dhe përvojë në hetimin dhe/ose ndjekjen e krimeve ekonomike.

25.10. Anëtarët e KKK-së e zgjedhin një anëtar të KKK-së për të shërbyer si Kryesues i KKK-së. Kryesuesi ka mandat prej një viti.

Organizimi dhe votimi

Neni 26

26.1. Kryesuesi do të përfaqësojë, menaxhojë dhe organizojë punën e KKK-së.

26.2. Kryesuesi është i autorizuar që të caktojë një anëtar të posaçëm për të organizuar dhe menaxhuar punën e KKK-së në një sferë të caktuar veçanërisht.

26.3. Kryesuesi do t'i thërrasë mbledhjet e KKK-së kur dhe siç e konsideron ai të domosdoshme ose kur kërkohet nga dy anëtarë tjerë të KKK-së.

26.4. Kuorumi për mbledhjet e KKK-së duhet të jetë tre (3) anëtarë.

26.5. Kryesuesi i kryeson mbledhjet e KKK-së. Në raste të jashtëzakonshme kur është e domosdoshme për KKK-në që të mbajë mbledhje në mungësë të kryesuesit, kryesuesi duhet të autorizojë njërin nga anëtarët e tjerë të KKK-së që të kryesojë mbledhjen.

26.6. Të gjitha vendimet duhet të ndërmirren me shumicën e votave nga anëtarët e pranishëm dhe që votojnë.

26.7. KKK-ja mund të të vendosë, kur e gjykon të domosdoshme, rregulla shtesë të procedurës për rregullimin e aktiviteteve të saj. KKK-ja duhet të publikoj dhe siguroj një kopje të rregullave në fjalë çdo personi që e kërkon këtë.

Mirëbesimi Neni 27

27.1. Nga të gjithë anëtarët, punëmarrësit, personeli dhe këshilluesit e KKK-së kërkohet që t'i marrin të gjitha masat e duhura që përkojnë me një shkallë të lartë të mbrojtjes së të dhënave të nxjerrura ose të pranuar nga KKK-ja gjatë një hetimi në vijim e sipër ose lidhur me një ndërmarrje të veçantë. Masat e tilla duhet të jenë të mjaftueshme për t'u siguruar që të dhënat në fjalë janë të mbrojtura nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia.

27.2. KKK-ja nuk mund ta konsiderojë si të fshehtë një informacion zbulimi, publikimi, ose shfrytëzimi i përgjithshëm i të cilit kërkohet ose lejohet me këtë ligj ose ndonjë ligj tjetër.

27.3. Çdo shkelje e qëllimshme ose shkeljet e përsëritura nga pakujdesia të detyrës për ruajtjen e fshehtësisë të përcaktuar në nenin 27.1 do të shërbejë si bazë e mjaftueshme për shkarkimin e anëtarit përkatës ose përfundimin e marrëdhënjes së punës me punëmarrësin, personelin ose këshilluesin përkatës.

Shkarkimi dhe suspendimi i anëtarëve Neni 28

28.1. Kuvendi me shumicë votash mund të largojë ose suspendojë një anëtar të KKK-së, përmes miratimit të një rezolute për këtë qëllim.

28.2. Kuvendi largon ose suspendon një anëtar të KKK-së nëse, pas mbajtjes së një seancë të plotë dhe të drejtë të ndëgjimit mbi këtë qështje, gjykata kompetente vërteton se anëtari përkatës (i) nuk i përmbush, ose më nuk i përmbush, kushtet e anëtarësisë të caktuara në nenin 25, (ii) ka kryer vepër penale ose jo-etike gjatë ose në lidhje me detyrat e tija zyrtare, ose (iii) qëllimisht ka shkelur ose më shumë se një herë nga neglizhenca ka shkelur kushtet e fshehtësisë (konfidencialitetit) të caktuara në nenin 27. Nëse vendimi i gjykatës u nënshtrohet procedurave të mëtutjeshme gjyqësore, Kuvendi e suspendon anëtarin deri në vendosjen përfundimtare të rastit nga gjykata. Nëse vendimi i gjykatës nuk u nënshtrohet procedurave të mëtutjeshme gjyqësore, Kuvendi nxjerr vendimin për largimin e anëtarit.

28.3. Nëse një anëtar i KKK-së është subjekt në procedurën gjyqësore që përfshin pohimet se anëtari në fjalë ka kryer vepër penale ose të pandershme gjatë ose në lidhje me ushtrimin e detyrave të tij zyrtare, gjykata do të nxjerrë një vendim që do të

suspendojë anëtarin në fjalë derisa gjykata të ketë mundësinë për të mbajtur një seancë gjyqësore të gjithëanshme dhe të paanshme mbi pohimet dhe të merr vendim për këtë gjë.

28.4. Anëtar i KKK-së që përjashtohet sipas nenit 28 do të vazhdojë të marrë rrogën e tij/saj gjatë periudhës së përjashtimit.

KREU 2 MARRJA E INFORMATAVE

Autorizimi për marrjen e Informatave Neni 29

29.1. KKK-ja do të ketë kompetenca të përgjithshme dhe autorizim, gjer në masën e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të dhëna me këtë ligj, për:

- a. të nxjerrë një urdhër për secilin person, ndërmarrje ose autoritet publik, duke i kërkuar personit, ndërmarrjes ose autoritetit të tillë publik të dorëzoj dhe/ose lejojë qasje në të dhënat, informacionet, dokumentet, materialet dhe/ose çështjet tjera të pronave të luajtshme dhe/ose të paluajtshme të cilat KKK-ja, gjatë përdorimit të arsyeshëm të lirisë së veprimit dhe gjykimit, i çmon të rëndësishme për ushtrimin e atyre funksioneve; dhe/ose
- b. të nxjerrë çfarëdo urdhëri për cilindo person që të siguroj dëshmi gojore ose me shkrim ose informacione në lidhje me çfarëdo çështje që KKK-ja, gjatë përdorimit të arsyeshëm të lirisë së veprimit dhe gjykimit, e çmon si të domosdoshme për ushtrimin e atyre funksioneve.

29.2. Pa i cenuar kompetencat e përgjithshme dhe autoritetin e KKK-së sipas nenit 29.1, KKK-a është veqanërisht e autorizuar që të nxjerrë urdhërin e specifikuar në nenin 29.1 me qëllim të marrjes së çfarëdo informacioni që KKK-ja e konsideron të domosdoshme për:

- (i). bërjen e analizave të situatës konkurruese në Kosovë; duke përcaktuar tregun lidhur me mallrat dhe shërbimet;
- (ii). shqyrtimin e një marrëveshje, aktiviteti, praktike ose vendimi që është në fushëveprimin e këtij ligji;
- (iii). marrjen e vendimit për lejimin ose mos lejimin e një përjashtimi të paraparë më këtë ligj;
- (iv). konstatimin nëse një ose më shumë ndërmarrje kanë pozitë dominuese; dhe/ose
- (v). mbikëqyrjen e aktiviteteve të një ose më shumë ndërmarrjeve që kanë pozitë dominuese.

29.3. Urdhëri i nxjerrë nga KKK-ja sipas këtij neni 29 duhet të jetë me shkrim dhe duhet të parashtrij:

- (i) qëllimin dhe bazën juridike të urdhërit në,
- (ii) karakterin e të dhënave, informacioneve, dokumenteve, çështjet e pronave të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, dhe/ose dëshmitë që kërkohen nga KKK-ja,
- (iii) periudhën për ekzekutimin e urdhërit, që nuk duhet të jetë më pak se dhjetë (10) ditë kalendarike, dhe
- (iv) njoftimin për mundësinë e vendosjes së dënimeve administrative ose penale në rast të mospërbushje të urdhërit në mënyrë të plotë dhe mashtuese.

29.4. Nëse urdhëri i drejtohet personit, KKK-ja do t'ia drejtojë urdhërin në fjalë personit të tillë dhe do t'ia dërgojë urdhërin (i) drejtpërdrejtë personit, (ii) në zyrën, vendin e afarizmit ose vendpunimin e tij/saj, ose (iii) në adresën e tij/saj të shtëpisë. Personit të cilit i drejtohet urdhëri i tillë do të konsiderohet se e ka pranuar personalisht urdhërin në fjalë në kohën e dërgimit.

29.5. Nëse urdhëri i drejtohet një ndërmarrjeje ose autoriteti publik, KKK-ja do t'ia drejtojë urdhërin në fjalë menaxherit ose zyrtarit të lartë të ndërmarrjes ose autoritetit publik dhe do ta dërgojë urdhërin në adresën e regjistruar të zyrës qendrore të ndërmarrjes ose autoritetit publik në fjalë.

Marrja e dëshmimeve gojore ose informacioneve Neni 30

30.1. Nëse, sipas nenit 29, KKK-ja nxjerr një urdhër që kërkon nga një person që të siguroj dëshmi gojore ose informata, urdhëri në fjalë duhet të parashtrij, përveç çështjeve të cekura në nenin 29.3, (i) emrin dhe, nëse dihet, titullin zyrtar të personit, (ii) vendin dhe kohën e paraqitjes dhe (iii) njoftimin mbi obligimet e tij/saj sipas nenit 30.2.

30.2. Nëse, për arsye të lejuara dhe bindëse, personi në fjalë nuk është në gjendje që të paraqitet në vendin dhe kohën e saktësuar në urdhër, ai/ajo duhet t'i dërgojë KKK-së një deklaratë me shkrim mbi arsyet e mosparaqitjes së tij brenda një afati kohor të arsyeshëm pas pranimit të urdhërit. Nëse KKK-ja, gjatë përdorimit të arsyeshëm të kompetencës diskrecionare, vërteton se motivet e paraqitura në deklaratë e arsyetojnë caktimin e sërishëm të paraqitjes, KKK-ja mund të ndryshojë urdhërin duke caktuar një vend dhe/ose kohë tjetër për paraqitje.

Sigurimi i dokumenteve dhe materialeve Neni 31

31.1. Nëse, sipas nenit 29, KKK-ja nxjerr një urdhër që kërkon nga një person, ndërmarrje ose autoritet publik që t'i dorëzoj dokumentet, projektet ose materialet e tjera, KKK-ja ka të drejtë dhe është e autorizuar që të kërkoj origjinalet e atyre dokumenteve ose kopjet e tyre. Nëse KKK-ja vendos që t'i pranojë kopjet, duhet të kërkoj nga personi, ndërmarrja ose autoriteti përkatës publik që t'i çertifikojë kopjet në fjalë për të dëshmuar se ato janë kopje të vërteta dhe të njëjta me origjinalin. KKK-ja do të vazhdojë të ketë të drejtën dhe autoritetin që, në çdo kohë, të kërkoj dorëzimin e origjinalit.

31.2. Me kërkesën e një personi, ndërmarrje ose autoriteti publik që dorëzon dokumente, projekte ose materiale të tjera, KKK-ja do të nxjerrë një vërtetim me shkrim që e vërteton pranimin e materialeve në fjalë.

31.3. Nëse një person, ndërmarrje ose autoritet publik e dorëzon origjinalin e dokumentit, projektit dhe ose materialeve të tjera në KKK, KKK-ja do t'ia kthejë origjinalin e tillë personit, ndërmarrjes ose autoritetit publik përkatës pas shqyrtimit të çështjeve në fjalë.

Autorizimi për inspektimin e pronës, vendit të afarizmit dhe depove të një Ndërmarrje

Neni 32

32.1. Nëse është e nevojshme për kryerjen e një hetimi për ndonjë shkelje të dyshuar të këtij ligji, KKK-ja mund të aplikojë para gjykatës kompetente të Qarkut për lëshimin e një vendimi që i autorizon zyrtarët e KKK-së që (i) të hyjnë, pa paralajmërim paraprak ose leje të veçantë, në selinë dhe ose çfarëdo pronë ose vendi tjetër të ndërmarrjes që shfrytëzohet për kryerjen e aktiviteteve afariste ose deponimit dhe (ii) të kërkojnë dhe inspektojnë artikuj të pronës së luajtshme ose të paluajtshme në vendet e tilla.

32.2. Gjykata përkatëse e Qarkut është e autorizuar që t'i lëshojë KKK-së vendimin në fjalë, nëse gjykata në fjalë vërteton se KKK-ja i ka përmbushur kushtet mbi provat dhe kushtet e tjera që kërkohen për lëshimin e vendimeve të tilla për policinë. Gjykata përkatëse e Qarkut mund të vendosë kufizime të arsyeshme në lidhje me fushëveprimin e vendimit në fjalë si dhe kohën në të cilin ai mund të zbatohet.

Kryerja e Kërkimeve dhe Inspektimeve në Zyrat ose Vendet e Zhvillimit të Afarizimit të Ndërmarrjes

Neni 33

33.1. Personat dhe ndërmarrjet janë të obliguara që t'ju lejojnë zyrtarëve të KKK-së që posedojnë vendimin e gjykatës të nxjerrë në përputhshmëri me nenin 32.2 për të kryer inspektimet përkatëse si dhe për të bashkëpunuar plotësisht me zyrtarë të tillë gjatë ndërmarrjes së kërkimit dhe inspektimit në fjalë.

33.2. Pronari, zyrtari, drejtori ose punëmarrësi i ndërmarrjes ka të drejtë ta vëzhgojë zhvillimin e kërkimeve dhe inspektimeve. Menjëherë para fillimit të një inspektimi, zyrtarët e KKK-së duhet ta njoftojnë pronarin, zyrtarin, drejtorin ose punonjësin e ndërmarrjes mbi këtë të drejtë.

33.3. Gjatë kërkimit dhe inspektimit të tillë, zyrtarët e KKK-së kanë të drejtë:

- a. që menjëherë t'i kontrollojnë dokumentet, projekt-dokumentet, dhe materialet tjera e objektet që kanë të bëjnë me aktivitetet e ndërmarrjes;
- b. që menjëherë të bëjnë ose të marrin, në shpenzime të ndërmarrjes përkatëse, kopje të dokumenteve dhe projekteve të tilla si dhe materialeve e artikujve të tjerë, saktësia e të cilave duhet certifikuar nga drejtori ose punonjësi apo zyrtari përgjegjës i ndërmarrjes nën inspektim si dhe personi ose personat që kanë bërë përgatitjen e kopjeve të tilla;
- c. që menjëherë ti shqyrtojnë të dhënat dhe bazën e të dhënave të mbajtura në formë elektronike ose në kompjuter a të deponuara në tjetër mjet elektronik, dhe
- d. që menjëherë të bëjnë ose të marrin, në shpenzim të ndërmarrjes përkatëse, kopjet e shtypura dhe kopjet elektronike të të dhënave dhe bazave të të dhënave, saktësia e të cilave do të verifikohet nga drejtuesi i lartë i ndërmarrjes ose personi ose personat që përgatisin kopjet e tilla.

33.4.Menjëherë pas përfundimit të kërkimit dhe inspektimit, zyrtari ose përfaqësuesi i autorizuar i KKK-së duhet të përgatisë, aty për aty, një raport mbi kërkimin dhe inspektimin, që paraqet:

- a. emrin e ndërmarrjes;
- b. lokacionin ose lokacionet e inspektuara;
- c. vendndodhjen dhe kohën e kontrollimit dhe inspektimit;
- d. emrin dhe pozitën e pronarit, zyrtarit, drejtuesit ose punëmarrësit të cilit zyrtarët e KKK-së ia prezantojnë vendimin gjyqësor apo autorizimin e KKK-së para ndërmarrjes së inspektimit;
- e. një përshkrim të hollësishëm të rrjedhës së kontrollimit dhe inspektimit dhe përfundimet e tij;
- f. listën e dokumenteve dhe materialeve të tjera që janë marrë gjatë zhvillimit të inspektimit dhe kërkimit;
- g. emrin e interpretuesit ose përkthyesit që ka marrë pjesë në inspektim, nëse ka patur sish;
- h. emrin/pozitën e çdo personi që ka penguar ose ka vështirësuar, ose ka tentuar të pengojë a vështirësoj, zhvillimin e kërkimit dhe inspektimit, nëse ka patur sish; dhe

33.5.Raporti i kërkuar nga neni 33.4 duhet të nënshkruhet nga një zyrtar i autorizuar i KKK-së. Zyrtari i tillë duhet që menjëherë t'ia jep një kopje të raportit ndërmarrjes. Ndërkaq kopja origjinale e raportit duhet t'i dorëzohet KKK-së.

33.6.Trajtimi i të gjithë dokumentacionit, materialeve dhe fakteve të tjera të marra gjatë kërkimit dhe inspektimit rregullohet me rregullat që janë ekuivalente për nga përmbajtja me ato që duhet të rrespektohen nga policia dhe prokurori publik për trajtimin e fakteve të tilla.

Konfiskimet Neni 34

34.1. KKK-ja mund t'i sekuestrojë dokumentet, materialet dhe artikujt e tjerë që me arsye beson se kanë vlerë materiale të dëshmive.Personi ose ndërmarrja e prekur me një konfiskim të tillë duhet të njoftohet pa vonesë të paarsyeshme.

34.2. Brenda tri (3) ditëve të punës pas sekuestrimit, KKK-ja do t'i drejtohet Gjykatës përkatëse të Qarkut për shqyrtimin e bazës ligjore të sekuestrimit. Personi ose ndërmarrja e prekur me sekuestrimin duhet:

- (i) të informohet për vendin dhe kohën e procedurës në gjykatën përkatëse dhe
- (ii) ka të drejtë të merrë pjesë, ose të përfaqësohet nga avokatë për paraqitjen e dëshmive dhe për të dëshmuar.

34.3.Kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut mbi bazën ligjore të sekuestrimit mund të bëhet apel në Gjykatës Supreme. Nëse Gjykata e Qarkut vendos se sekuestrimi nuk kishte bazë ligjore, dhe KKK-ja e informon gjykatën në fjalë se ka për qëllim që të apelojë kundër këtij vendimi, gjykata në fjalë mundet, nëse ajo mendon se veprimi i tillë është i nevojshëm për të siguruar paprekshmërinë e gjërave të sekuestruara ose praninë e tyre në Kosovë në pritje të ankesës në fjalë, të urdhërojë që artikujt e sekuestruar të vulosen dhe të vihen nën mbrojtje ligjore.

34.4.Përveq nëse Gjykata përkatëse e Qarkut ose Gjykata Supreme nxjerrë një vendim që thotë ndryshe, të gjithë artikujt e sekuestruar duhet t'i kthehen pronarit të tyre pas përmbylljes së hetimit përkatës ose brenda një viti pas sekuestrimit të tyre, cilado që është me herët. Gjykata përkatëse e Qarkut ose Gjykata Supreme mund të autorizojë KKK-së që të mbajë në posedim të saj artikujt e sekuestruar nëse gjykata në fjalë konstaton se një gjë e tillë është e nevojshme për të evituar pengimin ose paragjykimin e kryerjes së hetimit në fjalë ose procedurave gjyqësore.

PJESA VI MJETET JURIDIKE, DISPOZITAT NDËSHKIMORE DHE ÇËSHTJET PËRFUNDIMTARE

KREU 1 SHKELJET E LIGJIT DHE NDËSHKIMET

Vendosja e gjobave administrative dhe mjeteve të tjera juridike nga KKK-ja
Neni 35

35.1. Nëse KKK-ja konstaton se një marrëveshje, vendim ose praktikë e përbashkët ekzistuese ose e ardhme bën shkeljen e ndalesës të vendosur nga nenet 3, 10, 11 ose 12 të këtij ligji, KKK-ja mundet, që varësisht nga rrethanat, të nxjerrë një urdhër:

- a. që kërkon nga ndërmarrja ose shoqata përkatëse e ndërmarrjeve që të përmbahet nga ekzekutimi, zbatimi dhe ose kryerja e marrëveshjes, vendimit ose praktikës së tillë;
- b. që e shpall marrëveshjen, vendimin e tillë, ose cilëndo pjesë të këtyre të fundit, si të pavlerë, të shfuqizuar dhe të pazbatueshme;
- c. që kërkon nga ndërmarrja ose shoqata përkatëse e ndërmarrjeve që të marrin çfarëdo masa të tjera, masa këto që KKK-ja, në ushtrimin e diskrecionit të saj të arsyeshëm, i konsideron të nevojshme për të siguruar (i) eliminimin ose ndryshimin e efekteve negative në konkurrencë që janë shkaktuar nga marrëveshja, vendimi ose praktika e tillë, dhe (ii) që sjellja që ka shkaktuar efektet në fjalë të mos përsëritet më;
- d. që vendos një gjobë deri në 25.000 Euro, mbi cilindo person (i) që është pronar, zyrtar ose menaxher i cilësdo nga ndërmarrjet ose shoqatat përkatëse të ndërmarrjeve, dhe (ii) që ishte përzier thellësisht në procesin e vendim-marrjes që kishte shpër drejt bërjes së marrëveshjes, vendimit ose praktikës në fjalë;
- e. që vendos një gjobë deri në 100.000 Euro mbi (i) cilëndo ndërmarrje që është e përfshirë në ekzekutimin, zbatimin ose kryerjen e marrëveshjes ose praktikës në fjalë, ose (ii) çfarëdo shoqate të ndërmarrjeve që merr një vendim të tillë.

35.2. Nëse KKK-ja konstaton se një ose më shumë ndërmarrje ose një shoqatë e ndërmarrjeve është përfshirë në sjellje që e shkelin nenin 13, 17 ose 18 të këtij ligji, KKK-ja mundet, që varësisht nga rrethanat, të nxjerrë një urdhër:

- a. që kërkon nga ndërmarrjet përkatëse që të përmbahen nga sjelljet e tilla;
- b. që kërkon nga ndërmarrjet në fjalë që të marrin çfarëdo masa të tjera që KKK-ja në ushtrimin e diskresionit të saj të arsyeshëm, i ka konstatuar si të nevojshme për të siguruar (i) eliminimin ose ndryshimin e efekteve negative të sjelljes së tillë, dhe (ii) që sjellja e tillë të mos përsëritet;
- c. që vendos një gjobë deri në 20.000 Euro mbi cilindo person (i) që është pronar, zyrtar ose menaxher i cilësdo nga ndërmarrjet ose shoqatat përkatëse të ndërmarrjeve, dhe (ii) që ishte përzier thellësisht në procesin e vendim-marrjes që kishte shpjer drejt sjelljes së tillë, dhe/ose
- d. që vendos një gjobë deri në 100.000 Euro mbi cilëndo ndërmarrje që angazhohet në sjellje të tillë.

Ndëshkimet penale për moszbatimin e një urdhëri të KKK-së Neni 36

36.1. Çdo person që nuk i zbaton në tërësi dhe me ndershmëri urdhërat e vlefshme të lëshuara nga KKK-ja nën autozimin e këtij ligji do të përgjigjet penalisht për dështimin në fjalë. Nëse një ndërmarrje nuk e zbaton urdhërin në fjalë, personat e përgjegjës për dështimin e tillë do të përgjigjen penalisht për këtë dështim.

36.2. Çdo person që ndërhyt ose tenton të ndërhyt në punën e KKK-së gjatë ushtrimit të detyrave të tij zyrtare do të përgjigjet penalisht për ndërhyrjen ose tentim ndërhyrjen në fjalë.

36.3. Çdo person i dënuar për një shkelje të specifikuar në nenin 36.1 ose 36.2 është lëndë e një gjobe penale deri në 100.000 Euro dhe/ose tri vjet burgim.

Ankesat për dëmet, cenimet dhe mjetet tjera juridike Neni 37

37.1. Nëse personi ose ndërmarrja bën shkelje të dispozitave të këtij ligji, vendimit ose urdhërit të nxjerrë nga KKK-ja në bazë të këtij ligji, dhe shkelja e tillë shkakton ose rrezikon të shkaktojë, dëm të konsiderueshëm ekonomik (duke përfshirë humbjen e fitimit) ose tjetër dëm ndaj ndërmarrjes, personit ose palës së prekur negativisht do të ketë të drejtë të parashtroj ankesë në Gjykatën përkatëse të Qarkut duke kërkuar nga gjykata e tillë të nxjerrë, në varësi nga rrethanat, një urdhër:

- a. duke kërkuar nga shkelësi të kompenzojë dëmin e tillë;
- b. duke kërkuar nga shkelësi të ndërprejë sjelljen ose aktivitetin e ndaluar;
- c. duke kërkuar nga shkelësi të ndërmarr veprime pozitive për shmangjen e shkeljes;
- d. duke shfuqizuar, ndryshuar ose përshtatur një marrëveshje, vendim, praktikën ose tjetër sjellje që është në kundërshtim me këtë ligj.

37.2. Pronarët, drejtuesit dhe nëpunësit e një ndërmarrje, do të jenë përgjegjës individualisht dhe kolektivisht për çdo dëm finacial ose tjetër ndaj palëve të treta dhe ndërmarrjeve, të shkaktuar me shkeljen e këtij ligji.

KREU 2
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Shfuqizimi i ligjeve të mëparshme
Neni 38

Ky ligj dhe rregullat e zbatimit të nxjerra në bazë të këtij ligji do të zevëndësojnë të gjitha ligjet dhe rregullat e zbatimit që rregullojnë konkurrencën në Kosovë. Ligjet dhe rregullat e tilla të mëparshme do të pushojnë të kenë ndonjë efekt në Kosovë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Hyrja në fuqi
Neni 39

Ky Ligj hyn në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Kosovës dhe në ditën e shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Ligji Nr.2004/36
8 shtator 2004

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat Daci